

L.V. v. Departamenti i Arsimit i NYC, 03 Civ. 9917 (SDNY)

Prindërit e fëmijëve me Programe të Edukimit të Individualizuar që kanë marrë ose që mund të marrin një urdhër në përfundim të një seance të paanshme duhet të lexojnë njoftimin e bashkangjitur në lidhje me zbulimin e mundshëm të informacionit dhe dokumenteve për fëmijët e tyre si pjesë e një procesi gjyqësor federal.

Përkthimet në spanjisht, arabisht, bengalisht, kinezisht, frëngjisht, kreolisht, koreanisht, rusisht dhe urduisht janë të disponueshme në faqen e internetit të DOE në [Procesi i rregullt \(Due Process\): Seanca dëgjimore dhe ndërmjetësim i paanshëm](#)

Njoftim për zbulimin e mundshëm të të dhënave të arsimit të nxënësit

Ju lutemi lexoni me kujdes këtë njoftim. Ky është një mesazh në lidhje me zbulimin e mundshëm të dokumenteve ose të dhënave që mund të përmbajnë informacion për fëmijën tuaj, nëse fëmija juaj është klasifikuar si nxënëse me aftësi të kufizuara dhe ka qenë ose mund të jetë subjekt i një urdhri përfundimtar të seancës dëgjimore të paanshme.

I. Natyra e padisë

Kjo padi sfidoi dështimin e Department of Education (Departamenti i Arsimit) ("DOE") të qytetit të Nju-Jorkut për të zbatuar në kohë urdhrat e lëshuara nga zyrtarët e seancave dëgjimore të paanshme në lidhje me seancat dëgjimore të paanshme të mbajtura në përputhje me Ligjin për Arsimin e Individëve me Aftësi të Kufizuara ("IDEA"), U.S.C. titulli 20, seksioni 1400 dhe seksionet pasuese dhe Ligjin për Arsimin të Nju-Jorkut, seksioni 4401 dhe seksionet pasuese. Në vitin 2007, palët lidhën një marrëveshje për zgjidhjen e çështjes ("Marrëveshja") në të cilin DOE ra dakord që t'i zbatonte në kohë këto urdhra.

Në janar të vitit 2021, Gjykata miratoi kërkesën e paditësve për emërimin e një mjeshtri special. Më 14 Prill 2021, Gjykata miratoi një urdhër që emëronte David Irwin të Thru-Ed si Mjeshtër Special. Më 14 maj 2021, gjykata nxori një urdhër që përshkruan detyrat dhe autoritetin e Mjeshtrit Special, të cilat përfshijnë, ndër të tjera, autoritetin për të shqyrtuar proceset e DOE-s për zbatimin e urdhrave për seanca dëgjimore të paanshme dhe për t'i rekomanduar gjykatës përmirësime që i mundësojnë DOE-s zbatimin e urdhrave brenda afateve. Sipas këtij urdhri, Mjeshtri Special mund të ketë akses në regjistrat arsimorë të nxënësve, me kusht që DOE të respektojë dispozitat e Ligjit për të Drejtat Arsimore dhe Privatësinë e Familjes (U.S.C, titulli 20, seksioni 1232g; 34 C.F.R. pjesa 99) ("FERPA").

II. Të dhënat e urdhëruara për t'u zbuluar

Në mënyrë që Mjeshtri Special të kryejë detyrat e tij, Gjykata ka urdhëruar DOE që t'i sigurojë Mjeshtrit Special (dhe punonjësve dhe konsulentëve në Thru-Ed) qasje në të dhënat që përmbajnë informacion konfidencial të të dhënave të nxënësve, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, dokumente të paraqitura në procesin e seancave dëgjimore të paanshme, urdhrat e seancave dëgjimore të paanshme, të dhëna në lidhje me pajtueshmërinë dhe dokumentet e edukimit special të nxënësve, si programet e edukimit të individualizuar, vlerësimet, autorizimet, faturat, etj. Mjeshtrit Special i kërkohet të mbajë konfidencial çdo dokument dhe informacion të nxënësit. Asnjë informacion specifik për nxënësin nuk do të ndahet me avokatët e paditësve, përveç nëse prindi i nxënësit pranon në mënyrë specifike. Nëse ka ndonjë informacion specifik për nxënësin në raportet e Mjeshtrit Special në Gjykatë, ai informacion nuk do të bëhet publik.

Mjeshtri Special do ta përdorë këtë informacion vetëm për punën e tij për të shqyrtuar proceset e DOE për zbatimin e urdhrave të seancave dëgjimore të paanshme dhe për t'i rekomanduar Gjykatës përmirësime për t'i mundësuar DOE të zbatojë në kohë urdhrat. Zbulimi i këtij informacioni nuk prek ndonjë nga të drejtat tuaja si prind për të kërkuar shërbime të edukimit special për fëmijën tuaj.

III. Kundërshtimet e zbulimit

Nëse jeni dakord për zbulimin e këtij informacioni te Mjeshtri Special, nuk keni nevojë të bëni asgjë më shumë.

Nëse nuk dëshironi që informacioni i fëmijës suaj të ndahet me Mjeshttrin Special, ju duhet të kundërshtoni këtë zbulim duke paraqitur një kundërshtim tek avokati i DOE-së, drejtuar:

Jeffrey S. Dantowitz
NYC Law Department
100 Church Street, Room 2-121
New York NY 10007

ose me email në LVO objection@law.nyc.gov. Ju lutemi referoni padinë *LV kundër DOE* (Çështja nr. 03-9917) kur të shkruani. Ky njoftim shoqërohet nga një formular kundërshtimi, megjithëse asnjë kundërshtim me shkrim nuk do të refuzohet nëse nuk dorëzohet në këtë formular. Nëse kundërshtoni, Mjeshtrit Special nuk do t'i jepet asnjë regjistrim që përmban informacione personale të identifikueshme për ju dhe fëmijën tuaj ose informacione të tjera të mbrojtura nga FERPA, megjithëse mund të ndodhë zbulimi nominal dhe rastësor i emrit të fëmijës suaj. **Çdo kundërshtim duhet të merret brenda datës 3 dhjetor 2021 ose, për urdhrat e seancave dëgjimore të paanshme të lëshuar pas datës 12 nëntor 2021, brenda 3 javësh nga lëshimi i urdhrat të seancës dëgjimore të paanshme.**

Nëse dëshironi më shumë informacion rreth këtij njoftimi, ju lutemi të

kontaktoni avokatët e palës paditëse, Rebecca Shore, nga Advocates for Children of New York, Inc. në 646532-6078.